

VENDIM
Nr.29, datë 24.1.2007

PËR RISTRUKTURIMIN PËR EFEKT PRIVATIZIMI TË SHOQËRISË ANONIME
“ARMO”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 e 8 të ligjit nr.9117, datë 24.7.2003 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të “ARMO” sh.a. Fier”, të nenit 164 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, të nenit 4 të ligjit nr.7926, datë 20.4.1994 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, dhe të neneve 22 e 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e shoqërisë anonime “ARMO” të bëjë ndarjen e aseteve fikse dhe të llogarive financiare, që lidhen me veprimtarinë e pikave të tregtimit me pakicë të karburanteve, mbi bilancin e datës 31.12.2003.

2. Privatizimi i pikave të tregtimit me pakicë të karburanteve të bëhet në përputhje me procedurat e privatizimit të ndërmarrjeve dhe shoqërive tregtare shtetërore, të vogla dhe të mesme, të përcaktuara në vendimet nr.703, datë 11.10.2006 dhe nr.704, datë 11.10.2006 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe të shitjes së trojeve të ndërmarrjeve shtetërore apo të objekteve të veçuara, që i nënshtrohen privatizimit ose transformimit të tyre në shoqëri tregtare” dhe “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet, si dhe për procedurën e shitjes”.

3. Shoqëria anonime “ARMO” ruan të gjitha të drejtat mbi asetet, që i përgjigjen veprimtarisë së pikave të tregtimit me pakicë të karburanteve, deri në çastin e privatizimit të tyre. Të drejtat dhe detyrimet, më 31.12.2006, mbeten për llogari të shoqërisë “ARMO” sh.a.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha